**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

Nr. 186, datë 22.12.2023

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË TRANSFERTËS SË PAKUSHËZUAR TË PËRGJITHSHME SHTESË, TË ALOKUAR NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR.6, DATË 14.12.2023 "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 84/2022, "PËR BUXHETIN E VITIT 2023", TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa ndyshime dhe shtesa në ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.150, datë 22.12.2022 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023", si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme shtesë prej 127,690 mijë lekë, të alokuar në zbatim të Aktit Normativ nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar, sipas tabelës së mëposhtëme:

| Programi buxhetor | Emërtimi projektit | Llog. Ekonomike | Fondi në mijë lekë |
|---|---|---|---|
| 01110 | Shlyerje e detyrimeve të prapambetura | 602 | 127 690 |

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS

**U shpall sot me datë 22.12.2023**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS SEKRETARIA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr. 826/4 prot.

Durrës, më 22.12.2023

22/12/23 12103/6

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**DURRËS**

**KRYETARIT TËBASHKISË**
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.186 datë 22.12.2023 " Për miratimin e përdorimit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme shtesë të alokuar në zbatim të aktit normativ nr.6, datë 14.12.2023 "për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022 "për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar "

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Adresa: Sheshi "LIRIA" Durrës, Shqipëri,e-mail: Prefekti.Durres@mb.gov.al Tel:+355 52 225 528,prefektidurres.gov.al